

PLAN STRATEGJIK ZHVILLIMI
DEPARTAMENTI I GJUHËVE TË HUAJA
(2016-2020)

Si një njësi përbërëse e Fakultetit të Edukimit dhe Filologjisë, Departamenti i Gjuhëve të Huaja ka si mision krijimin, zhvillimin, transmetimin dhe mbrojtjen e dijeve me anë të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor. Në veprimtarinë e tij akadmeike, mësimore dhe shkencore, kjo strukturë synon:

- *ofrimin e programeve të studimit që formojnë specialistë në drejtimet e gjuhësisë dhe kulturës angleze dhe franceze, si dhe në fushat e mësimdhënies dhe të nxënimit të këtyre dy gjuhëve të huaja.*
- *forcimin e strukturave të të nxënimit gjatë gjithë jetës nëpërmjet përditësimit të vazhdueshëm të njohurive për mësuesit në detyrë.*
- *ofrimin e shërbimeve dhe krijimin e infrastrukturës së duhur fizike dhe njerëzore që lidhet me mbrojtjen e provimeve kombëtare dhe ndërkombëtare të këtyre dy gjuhëve.*
- *sigurimin e vazhdueshëm të cilësisë së brendshme dhe rritjen e konkurrencës së diplomave në kontekstin e arsimit të lartë në vend, si dhe në kontekstin e arsimit në përgjithësi.*
- *rritjen e cilësisë së kërkimit shkencor dhe vënien e tij në dispozicion të zhvillimit shoqëror dhe kulturor të rajonit.*

1. PROGRAMET E STUDIMIT

Departamenti i Gjuhëve të Huaja synon ofrimin e programeve të studimit 2-vjeçar me karakter profesional, programe studimi të ciklit të parë- Bachelor, të ciklit të dytë- Master Profesional dhe Master të Shkencave, si dhe programe të ciklit të tretë – Master Ekzekutiv. Sipas specifikace përkatëse, objektivat që synojnë të arrijnë programet e studimit janë:

- formimin e kompetencave gjuhësore, shkencore, psikopedagogjike, të cilat përputhen me kërkesat e një shoqërie të zhvilluar për punësim dhe për ruajtjen e vlerave kulturore si dhe interesave kombëtare;
- nxitjen e mendimit kritik përmes një kurrikule me bazë kompetencat e të nxënimit;
- pajisjen me aftësi të hulumtimit të burimeve të informacionit, të përpunimit të të dhënave dhe të analizës.
- përgatitjen e mësimdhënësve të suksesshëm të gjuhëve të huaja, me aftësi të thella profesionale dhe cilësi morale, të aftë të përballen me sfidat e një shoqërie në zhvillim;

Këto objektiva synohen të arrihen nëpërmjet:

- 1.1 Konsolidimit, përditësimit dhe ristrukturimit të kurrikulave të programeve të studimit të ciklit të parë me qëllim përshtatjen e tyre me objektivat e formimit, rezultatet e të nxëniet dhe kërkesat e një shoqërie në zhvillim.
- 1.2 Krijimi i programeve me karakter 2-vjeçar profesional me qëllim aftësimin profesional të maturantëve që kërkojnë punësim të menjëhershëm në tregun e punës.
- 1.3 Ristrukturimi i programeve aktuale të ciklit të dytë dhe krijimi i programeve të përbashkëta të ciklit të tretë – krijimi dhe konsolidimi i kushteve për hapjen e programeve Master Ekzekutiv me njësi simotra në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.

2. KËRKIMI SHKENCOR

- 2.1 Vënia e veprimtarisë kërkimore shkencore në dispozicion të rritjes së cilësisë së mësimdhënies.
- 2.2 Vënia e veprimtarisë kërkimore shkencore në dispozicion të palëve të interesuara në tregun e punës.
- 2.3 Rritja e kapaciteteve kërkuese të laboratorëve, mediatekës dhe bibliotekës së fakultetit.
- 2.4 Krijimi i një ambienti dinamik në lidhje me rezultatet e përditësuara të kërkimit shkencor.

3. STUDENTËT

- 3.1 Gjetja e mënyrave dhe strategjive për përthithjen e vazhdueshme të prurjeve cilësore të studentëve që regjistrohen në programet e studimit. Ruajtja e lidhjeve të vazhdueshme me insitucionet e arsimit parauniversitar me qëllim promovimin e programeve të studimit.
- 3.2 Përfshirja aktive e studentëve në vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe në ristrukturimin e kurrikulave;
- 3.3 Nxitja e kontributit të studentëve në fushat e kërkimit shkencor të departamentit dhe promovimi i saj nëpërmjet aktiviteteve në rang institucional dhe ndërinstitutional.
- 3.4 Krijimi i një baze të dhënash për ruajtjen e lidhjeve me studentët e diplomuar; përfshirja e alumni në ristrukturimin e kurrikulave dhe në sigurimin e cilësisë.
- 3.5 Plotësim i nevojave të studentëve në lidhje me aktivitetet jashtë-kurrikulare.
- 3.6 Vendosja e lidhjeve të qëndrueshme me tregun e punës dhe rritja e komunikimit me Qendrën e Karrierës si urë lidhëse mes studentëve dhe kërkesave të këtij të fundit

4. STAFI AKADEMIK DHE ADMINISTRATIV

- 4.1 Rritja akademike e stafit mësimdhënës dhe promovimi i dijeve të përftuara nga kërkimi shkencor.
- 4.2 Përkrahje e vazhdueshme e mësimdhënies aktive, kërkimit shkencor cilësor dhe përgjegjësisë morale dhe sociale për formimin e një brezi të ri mësuesish dhe qytetarësh të denjë.
- 4.3 Integrimi i platformave elektronike në aktivitetin akademik.
- 4.4 Nxitja e mobiliteteve mësimdhënëse dhe trajnuese të stafit akademik.
- 4.5 Krijimi i lidhjeve funksionale dhe shkëmbimeve akademike mes institucioneve simotra që ofrojnë programe dhe shërbime të ngjashme.
- 4.6 Sigurimi i shërbimeve të vazhdueshme për informimin dhe këshillimin e studentëve gjatë dhe në përfundim të studimeve.

5. INFRASTRUKTURA

- 5.1 Vënia e infrastrukturës mbështetëse mësimore dhe kërkimore në funksion të objektivave të të nxënimit dhe nxitja e sjelljes dhe integritit të risive të teknologjisë së informacionit në mësimdhënie nëpërmjet laboratorëve tashmë në përdorim.
- 5.2 Vënia në funksion të plotë e Mediatekës së Gjuhëve të Huaja, pasurimi i literaturës që ajo ofron dhe krijimi i një axhende të aktiviteteve jashtëkurrikulare që lidhin studentët me realitetet britanike, amerikane dhe frankofone.